



Datë:14.04.2026

A.nr.232/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.232/2026, të datës 03.03.2026, të parashtruar nga ankuesi Xh.D, kundër organit të punësimit/Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, në çështjen juridike “*vlerësim i rezultateve në punë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.04.2026, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.232/2026, të datës 03.03.2026, të parashtruar nga ankuesi Xh.D.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil Xh.D (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 03.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit të datës 20.02.2026, lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Kolegji i Këshillit*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 10.03.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa, kjo e fundit më datë 13.03.2026, ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesa me numër protokollit 1091/2026 të datës 03.03.2026, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 20.02.2026; Kopjen e ID-së së ankuesit; Përshkrimin e punës Udhëheqës i Sektorit të Inspektionit Sanitar dhe Koordinator i Zyrës Rajonale; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.03.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 13.03.2026; Vendimin Ref. AUV, 01-320/2018 të datës 05.09.2018, për caktimin e ankuesit në pozitën *Koordinator i Zyrës Rajonale në Mitrovicë*; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës

06.03.2026; Emailin e datës 11.03.2026 nga Drejtori i Inspektoratit për Udhëheqësen e Njësinë së Burimeve Njerëzore në AUV; Emailin e datë 09.03.2026 nga Sh.O për I.Z; Emailin e datës 11.03.2026 nga Sh.O për B.H; Vërejtjen me shkrim të datës 27.01.2026 për ankuesin; Emailin e datës 11.03.2026 nga E.D për I.Z; Kërkesën për informata zyrtare e datës 08.04.2026 nga A.B për M.Sh; Përgjigjen në kërkesë për informata zyrtare e datës 08.04.2026 nga M.Sh për A.B.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.232/2026, *sepse:*

I. Gjendja e çështjes

Nga administrimi i provave të çështjes rrjedhë se ankuesi sipas Vendimit Ref. AUV, 01-320/2018 të datës 05.09.2018, ushtron pozitën *Koordinator i Zyrës Rajonale në Mitrovicë* në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë. I njëjti më datë 20.02.2026, ka pranuar formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2025 më nivel të vlerësimit ” *Ka nevojë për përmirësim*”.

II. Pretendimet ankimore dhe përgjigjja në pretendime ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill kundërshton vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2025 sipas Formularit të datës 20.02.2026, duke pretenduar së mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë nuk ka mbajtur takim edhe pse është kërkuar mbi 10 herë si dhe nuk ka pranuar asnjë plan të punës, kështu që vlerësimi është në kundërshtim me Rregulloren për Vlerësimin e Rezultateve në Punë dhe Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë.

Në përgjigjen në ankesë të datës 13.03.2026, organi i punësimit, ka përcjell formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin të datës 06.03.2026, sipas të cilit akt rezulton se ankuesi lidhur më rezultatet në punë për vitin 2025 është rivlerësuar më nivel të përgjithshëm “ *Arrin Pritshmërinë*”.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Duke qenë së ankuesi më ankesë kundërshton Formularin e vlerësimit të datës 20.02.2026, me nivel të vlerësimit “ *ka nevojë për përmirësim*”, ndërsa, organi i punësimit ka përcjell formularin e datës 13.03.2026, me nivel të vlerësimit ” *arrin pritshmërinë*”, Këshilli, më datë 08.04.2026, i është drejtuar më shkrim Njësisë së Burimeve Njerëzore të Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë më kërkesë që kjo e fundit të saktësoj faktin se cili formular është akt përfundimtar lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2025, ndërsa, Njësia e Burimeve Njerëzore të Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë po më datë 08.04.2026 ka njoftuar Këshillin që duke ju referuar pikës 3 të emailit të datës 11.03.2026 të mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë e ankuesit është përmirësuar vlerësimi për z. D.

Rrjedhimisht, duke qenë së vlerësimi përfundimtar i rezultateve në punë për vitin 2025 është përmirësuar sipas formularit të datës 04.03.2026, në atë mënyrë që vlerësimi nga niveli ” *ka nevojë për përmirësim*” është ndryshuar në nivelin” *Arrinë Pritshmërinë*”, atëherë, në vlerësimin e Kolegjit qëllimi i ankesës ndaj Formularit të vlerësimit të rezultateve në punë të datës 20.02.2026 është bërë i

pamundur për shqyrtim dhe vendosje, kështu që, në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilin është përcaktuar se: “*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot*”, Kolegji erdhi në përfundimin së duhet të përfundoj procedura ankimore e iniciuar sipas ankesës së datës 03.03.2026.

Kolegji në kuptim të informimit të palës ankuese, rikujton dispozitat e nenit 52 paragrafi 17 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 14 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, më të cilat është paraparë se: 1. *Nëpunësi civil i pakënaqur me vlerësimet “e papranueshme” dhe “ka nevojë për përmirësim” ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHCK brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve.*, pra, nëpunësi civil mund të ushtroj ankesë në Këshill vetëm në rast të vlerësimit “ ka nevojë për përmirësim” dhe “ e papranueshme”.

Thënë si më sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.232/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit Xh.K;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.